Wilson Center Digital Archive
International History Declassified
digitalarchive.wilsoncenter.org

# November 14, 1968

# Report on a meeting between the Ambassador of the United Arab Republic Gamal Eldin Sabet with Reiz Malile, the Albanian Ambassador to China

## Citation:

"Report on a meeting between the Ambassador of the United Arab Republic Gamal Eldin Sabet with Reiz Malile, the Albanian Ambassador to China", November 14, 1968, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh, V. 1968 D.154
https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/110157

## Summary:

This report documents a meeting between the Ambassador of the United Arab Republic (UAR) Gamal Eldin Sabet with Reiz Malile, the Albanian Ambassador to China. The Ambassador declared that there are no Soviet bases in the UAR and that his country would never accept the fact that military sea bases in the UAR would be exploited for aggression against the People's Republic of Albania, with whom the UAR has friendly relations. Nevertheless, the ambassador stresses that this is his opinion and not the official opinion of the government of the UAR.

## Original Language:

Albanian

## Contents:

Original Scan

Wilson Center Digital Archive Original Scan

MPJ Arkivi
Viti
Dosja
I DEKLASIFIKUAR

Tirane,me 14/XI/1968.

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja
Fleta:

# I N F O R M A C I O N

## MBI TAKIMIN E AMBASADORIT TE R.A. TE BASHKUAR GAMAL ELDIN SABET ME SHOKUN REIZ MALILE

Me 14 nendor 1968,ambasadori i R.A. te Bashkuar Gamal Eldin Sabet takoi me kerkesen e tij shokun Reiz Malile.Gjate bisedes ai ngriti keto çeshtje:

I.Lidhur me letren qe shoku Haxhi Lleshi i ka drejtuar Presidentit te R.A. te Bashkuar Naser,ambasadori permendi se i kishte thene Zv.Ministri i RAB-it,Salih Anuar,shokut Ylvi Lulo se "ne Republiken Arabe te Bashkuar nuk ka baza sovjetike dhe se nuk do te pranojme ne asnje menyre qe bazat ushtarake detare te RAB-it te shfrytezohen per agresion kunder Republikes Popullore te Shqiperise,me te cilen kane maredhenije miqesore".Mbas kesaj ambasadori pyeti ne se ky mesazh i eshte drejtuar vetem Presidentit Naser,apo edhe kryetareve te shteteve te tjere qe ndodhen ne kete zone;dhe ne se ne kemi te dhena mbi numurin e anijeve lufterake sovjetike ne Mesdhe.

Shoku Reiz i spjegoi ambasadorit se kjo leter i eshte drejtuar vetem Presidentit Naser,ndersa per pyetjen e dyte shoku Reiz i tha se ne nuk kemi te dhena mbi numurin e anijeve sovjetike,por ne Kajro me siguri i dinin keto.Per verifikim,shoku Reiz pyeti ambasadorin ne se kjo ishte pergjigje zyrtare lidhur me letren qe shoku Haxhi Lleshi i drejtonte Presidentit Naser dhe ambasadori tha se kjo nuk ishte pergjigje zyrtare,por ai e tha kete nga vehtja e tij.

Gjate bisedes shoku Reiz demaskoi bashkepunimin sovjeto-amerikan,planet e tyre per ndarjen e zonave te influences,denoi agresionin sovjetik kunder Çekosllovakise,i foli ambasadorit mbi rrezikshmerine qe paraqet flota sovjetike ne Mesdhe per vendet e kesaj zone dhe vete Republikes Arabe te Bashkuar dhe nevojen per te qene vigjilent,e tj.

Wilson Center Digital Archive
Original Scan

MPJ ARKIVI
Viti
Dosja

I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:  Fleta:

62



II. Ambasadori u lut t'u pergjigjemi notave te ambasades se tyre te 26 tetorit mbi takset e benzines dhe te 12 nendorit mbi disa monedha ari.

III. Ambasadori u lut gjithashtu qe neve te lejojme shoferin shqiptar qe ka ai per ta mare me vehte ne udhetimet ne makine jashte Shqiperise, psh. ne Tetograd, Ohri, e tj.

Shoku Reiz e refuzoi kete duke i spjeguar ambasadorit se nga ana jone shoferit i eshte kerkuar pergjegjesi e plote per sigurimin e ambasadorit, se kete detyre ai do te jete ne gjendje ta kryej brenda territorit te RP te Shqiperise, ndersa jashte vendit mund te behen edhe provokocsione, qe kane ndodhur ne te kaluaren, dhe nga ana tjeter ne nuk duam te krijojme ndonje precedence ne kete drejtim, abasi edhe ambasadore te vendeve te tjera na kane ~~kerk~~ kerkuar nje gje te tille. Ambasadori tha se ai kupton plotesisht arsyet qe ju parashtruam.

IV. Gjate bisedes ambasadori kerkoi dhe ju premtua ti dergohet Historia e Shqiperise ne anglisht. (Kjo ju dergua me kartvizite te shokut Reiz).

V. Ambasadori shprehu keqardhjen qe autoritetet egjyptiane nuk ishin vene ne dijeni ne kohe per te organizuar pritjen e delegacionit tone te kryesuar nga shoku Beqir Balluku kur ai kthehej nga RPK per ne Atdhe, ndonse nga ambasada jone ne Kajro ata ishin njoftuar se delegacioni nuk do te ndalonte ne RAB. Ai vuri gjithashtu ne dukje se edhe kur delegacioni ndodhej ne Kajro, sh. Beqiri nuk kishte shprehur deshiren te takohej me personalitete egjyptiane, ne gjithse protokolli i tyre ishte interesuar prane ambasades sone. Ambasadori i ngriti keto se mos kishte ndonje keqkuptim nga ana e jone lidhur me pritjen e bere. Shoku Reiz i spjegoi ambasadorit se nuk ishte planifikuar qe delegacioni te qendronte ne Kajro dhe se ndalesa atje u be e detyruar nga arsye teknike dhe siguroi ambasadorin se nuk kishte asnje keqkuptim nga ne lidhur me pritjen qe ju rezervua delegacionit tone.

Sokrat Como
[signature]